



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:108070

Datë: 15.10.2021

Numri i dokumentit: 02284778

C.nr.874/18

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me sekretaren juridike Drita Haxhishabani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: 1. G. M., 2. F.M., 3. F. M., 4.L. M. dhe e mitura A. M., me përfaqësuesin e saj ligjor G. M., të gjithë nga fshati . . . , Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson i autorizuari Safer Morina avokat nga Prizreni, rr.”William Walker” nr.11, kundër të paditurës K. S. P.”-Sh.a, nga Prishtina, rr.”. . .”, pa nr, lagjja . . . , me objekt të padisë për kompensim dëmi, vlera e kontestit 42.765,38 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në prezencë të autorizuarit të paditësve si dhe të autorizuarit të paditurës, me datë 16.09.2021, morri këtë:

A K T G J Y K I M

]

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve 1. G. M., 2. F.M., 3. F. M., 4.L. M. dhe e mitura A. M., me përfaqësuesin e saj ligjor G. M., të gjithë nga fshati . . . , Komuna e Rahovecit dhe **DETYROHET** e paditura K. e S.“P.” Sh.A, me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugorë, të dt.23.09.2018, nga baza e auto përgjegjësisë, t’ia kompensoj paditësve shumat si në vijim:

1. Paditësit G. M.:

Dëmi jo material

- Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 2.000,00 euro.
- Për të gjitha format e frikës shumën 1.500,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5.95% shumën 1.500,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 750.00 euro.

Dëmi material.

- Për perkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 350,00 euro.
- Për ushqimin e përforcuar shumën 350,00 euro.
- Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 700.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme për dëmin jo material dhe material prej **7.150,00 €**.

2. Paditësit F.M.:

Dëmi jo material

- Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 1.800,00 euro.
- Për të gjitha format e frikës shumën 1.300,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5.% shumën 1.000,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 500.00 euro.

Dëmi material.

- Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 300,00 euro.
- Për ushqimin e përforcuar shumën 300,00 euro.
- Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 700.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme për dëmin jo material dhe material prej **5.900,00 €**.

3. Padi tëses F. M.:

Dëmi jo material

- Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 2.000,00 euro.
- Për të gjitha format e frikës shumën 1.400,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 9.76% shumën 2.000,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 500.00 euro.

Dëmi material.

- Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 350,00 euro.
- Për ushqimin e përforcuar shumën 350,00 euro.
- Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 700.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme për dëmin jo material dhe material prej **7,300.00 €**.

4. Padi tëses A. M.:

Dëmi jo material

- Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 1.000,00 euro.
- Për të gjitha format e frikës shumën 500,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 3% shumën 1.000,00 euro.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 500.00 euro.

Dëmi material.

- Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 250,00 euro.
- Për ushqimin e përforcuar shumën 250,00 euro.
- Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 250.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme për dëmin jo material dhe material prej **3,750.00 €**.

5. Padi tëses L. M.:

Dëmi jo material

- Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 700,00 euro.
- Për të gjitha format e frikës shumën 500,00 euro.

Dëmi material.

- Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 100,00 euro.
 - Për ushqimin e përforcuar shumën 100,00 euro.
 - Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 250.00 euro,
- respektivisht shumën e përgjithshme për dëmin jo material dhe material prej **1,650.00 €**.

II. DETYROHET e paditura që paditësve për shumat e cekura në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi, t'iu paguaj edhe kamatë ligjore prej 8% në vit, si dhe shpenzimet kontestimore në shumën prej **3,670.00 euro**, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve 1. G. M., 2. F.M., 3. F. M., 4.L. M. dhe e mitura A. M., me përfaqësuesin e saj ligjor G. M., të gjithë nga fshati . . ., Komuna e Rahovecit, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar prej **29.200,00 euro, refuzohet si e pabazuar.**

A r s y e t i m

Paditësit 1. G. M., 2. F.M., 3. F. M., 4. L. M., dhe e mitura 5. A. M., me përfaqësuesin e saj ligjor G. M., të gjithë nga fshati . . ., Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson i autorizuari Safer Morina avokat nga Prizreni, në këtë Gjykatë kanë parashtruar padi, kundër të paditurës K. e S.“P.” Sh.a, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit jomaterial dhe material. Në referatin e padisë kanë theksuar se me dt.23.09.2018, rreth orës 20:30/h, në aksin rrugor Gjakovë-Prishtinë, pikërisht në fshatin Cërmjan, Komuna e Gjakovës, është shkaktuar aksidenti rrugor. Deri te aksidenti i trafikut ka ardhur me lëshimet (fajin) ekskluziv të vozitësit- I. H. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, i cili ka drejtuar automjetin e markës “. . .” me targa të regjistrimit . . ., ngjyrë e zezë metalike, i cili po qarkullonte në aksin rrugor Gjakovë-Prishtinë, në atë mënyrë që me të arritur në fshatin Cërmjan, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, i njëjti lëshon shirit e tij të rrugës, të anës së djathtë të drejtimit dhe kalon në shiritin e majtë në drejtim të kundërt, ku si pasoj e kësaj me pjesën ballore të anës së majtë e godet në pjesën e përparme të krahut të majtë automjetin e llojit “. . .” me targa të regjistrimit . . ., me ngjyrë të bardhë të cilin e drejtonte G. M., i cili ishte në përball kalim dhe si pasoj e inercionit del nga rruga dhe përplasat në një kanal të ujit, me ç rast pëson lëndime këtu i dëmtuari bashkë paditësi G. M. dhe pasagjerët që ishin në automjet me të, paditësit F.M., F. M., L. M. dhe E mitura A. M., të cilët po ashtu pësuan lëndime veçanërisht të rënda trupore. Pas aksidentit të dëmtuarit-paditësit me ambulancë janë dërguar në Spitalin Rajonal të Gjakovës dhe pas tretmanit mjekësor dhe ndihmës mjekësore, është konstatuar se të dëmtuarit kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura KS”P.” që ti paguajë paditësve shumat si në kërkesëpadi respektivisht shumën e përgjithshme prej 42.765.38 euro, si dhe kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

Me parashtrësën e dt.02.03.2021, i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin e kërkesëpadisë përmes së cilës ka kërkuar që gjykata të merr aktgjykim ashtu që të aprovohet kërkesëpadi e paditësve 1. G. M., 2. F.M., 3. F. M., 4.L. M. dhe e mitura A. M., me përfaqësuesin e saj ligjor G. M., të gjithë nga fshati . . ., Komuna e Rahovecit dhe DETYROHET e paditura K. e S.“P.” Sh.A, me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugorë, të dt.23.09.2018, nga baza e auto përgjegjësisë, t'ia kompensoj paditësve shumat si në vijim: Paditësit G. M.: Dëmi jo material - Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5.95% shumën 1.500,00 euro. - Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 2.500,00 euro.

- Për të gjitha format e frikës shumën 1.750,00 euro. - Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 1.500,00 euro. Dëmi material. - Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 500,00 euro. - Për ushqimin e përforcuar shumën 400,00 euro. - Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 700,00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive. Padi tësit F.M.: Dëmi jo material - Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5.% shumën 1.000,00 euro. - Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 2.000,00 euro. - Për të gjitha format e frikës shumën 1.400,00 euro. - Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 500,00 euro. Dëmi material. - Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 500,00 euro. - Për ushqimin e përforcuar shumën 350,00 euro. - Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 700,00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive. Padi tëses F. M.: Dëmi jo material - Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 9.76% shumën 2.000,00 euro. - Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 2.000,00 euro. - Për të gjitha format e frikës shumën 1.400,00 euro. - Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 500,00 euro. Dëmi material. - Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 500,00 euro. - Për ushqimin e përforcuar shumën 400,00 euro. - Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 700,00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive. Padi tësit A. M.: Dëmi jo material - Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 3% shumën 1.000,00 euro. - Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 1.000,00 euro. - Për të gjitha format e frikës shumën 700,00 euro. - Për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën 500,00 euro. Dëmi material. - Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 250,00 euro. - Për ushqimin e përforcuar shumën 250,00 euro. - Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 250,00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive. Padi tësit L. M.: Dëmi jo material - Për të gjitha format e dhimbjeve fizike-trupore shumën 700,00 euro. - Për të gjitha format e frikës shumën 500,00 euro. Dëmi material. - Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën 250,00 euro. - Për ushqimin e përforcuar shumën 250,00 euro. - Për rehabilitim mjekësor dhe për shpenzimet mjekësore shumën 250,00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive. II. DETYROHET e paditura që paditësve t'iu paguaj shpenzimet kontestimore në shumën prej 3.670,00 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive.

Në seancën për shqyrtim kryesor i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetemi në tërësi si në padi dhe parashtresën për precizimin e kërkesë padisë të dorëzuar kësaj gjykate me dt.25.02.2021. Pasi që sa i përket bazës juridike e njëjta nuk është kontestuese dhe se kjo është vërtetuar nga aktgjykimi penal të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe se po ashtu i njëjti është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës. Andaj propozoj që pas administrimit të provave të propozuara dhe provave të nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor padia dhe kërkesë padia e precizuar të aprovohet në tërësi si e bazuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe precizimit të kërkesëpadisë siq u theksua edhe më lartë e pasi që nga provat e administruara konsideroj se në tërësi dhe padyshim është vërtetuar gjendja faktike në këtë çështje kontestimore si dhe lartësia e kërkesëpadisë andaj propozoj gjykatës që ta aprovtoj padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar me të cilën do të obligohet e paditura K. e S.P. që paditësve të jua paguajë shumat e lartcekura si në petitumin e precizimit të kërkesëpadisë dhe atë me

kamatë ligjore 8% sipas LMD-së në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Gjithashtu të obligohet e paditura që përfaqësuesit të autorizuar të palëve paditëse të jua paguajë shpenzimet e procedurës sipas precizimit të kërkesës në shumën e përgjithshme prej 3,670.40 Euro.

Në seancën për shqyrtim kryesor i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë deklaratave pranë seancave të kaluara ashtu që njoftojmë gjykatën se kemi pranuar ekspertizat mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë ku ndaj të njëjtave nuk kemi vërejtje dhe nuk kërkojmë sqarime shtesë. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare të prezantuar në formë të shkruar ka deklaruar se: mbetemi në tërësi pranë deklarimeve tona gjatë procedurave të mbajtura, ashtu që nga fillimi i kësaj procedure gjyqësore e kemi kontestuar pjesërisht bazën juridike të kërkesëpadisë në vëllimin e lartësisë së dëmit, e po ashtu e kontestojmë edhe lartësinë e precizimit të kërkesëpadisë si të lartë dhe jo në harmoni me lëndimet e pësuar tek paditësit. E paditura për paditësin G. M., e konteston në pikëpamje të vëllimit të dëmit pasi i njëjti me mos përdorimin e rripit të sigurisë ka ndikuar që dëmi të jetë më i madh. Me dispozitat e nenit 187 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor përcaktohet se: "Në automjetin për udhëtarë dhe në mjetin transportues shoferi dhe të gjithë personat të cilët gjenden në mjet duhet ti përdorin rripin e sigurisë, siç e parasheh prodhuesi I atij automjeti", ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se " Nëse personi i mitur I cili transportohet në një mjet nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësia bie mbi shoferin e mjetit, ndërsa nëse personi I moshës madhore nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësinë për këtë e mban vetë personi". Se paditësi nuk ka mbajtur rripin e sigurisë vërtetohet nga fotot e automjetit të dëmtuar (pjesë e shkresave të lëndës) ku paditësi ka goditur xhamin e përparmë. Tutje, e paditura e konteston bazën e kërkesëpadisë në pikëpamje të vëllimit të dëmit edhe për paditësit e tjerë dhe atë, për shkak të mos përdorimit të rripit të sigurisë e mbështetur në dispozitën e lartcekur, dhe në bazë të tejkalimit të limit të ulëseve në automjet. Me dispozitat e nenit 182paragrafi 2 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, përcaktohet se: "Në mjet lejohet të transportohen vetën aq persona sa ka ulëse të montuara në mjet, përkatësisht sa janë të shënuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit", ndërsa në librezën si provë e shkresave të lëndës është e pakontestueshme që limiti i ulëseve është 2(dy),andaj, mbi këtë gjendje faktike paditësit kanë kontribuar në rritjen e vëllimit të dëmit. E paditura konteston lartësinë e kërkesëpadisë sepse shumata e përgjithshme e cila është kërkuar me anë të precizimit të kërkesëpadisë dhe atë për dhimbje trupore, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktiviteti jetësor dhe shëmtimin është jashtëzakonisht e lartë dhe në kundërshtim direkt me nenin 183 par.2 të LMD-së, i cili parasheh se me rastin e vendosjes së kërkesës për shpërbllim të dëmit jo material, si dhe lartësinë e shpërbllimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërbllim, por edhe për atë se me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj, andaj vlerësojmë se shumata e kërkuara bien në kundërshtim me qëllimin e përmendur si dhe me kriteret për vlerësimin e dëmeve jo material të përcaktuara me rregulloren e BQK-së, e miratuar me dt.31.08.2016. Kërkesën e paditësve për dëmin material lidhur me ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar, po ashtu i kundërshtojmë si të larta, pasi që për kërkesat e tilla lidhur me shërbimet që merren brenda familjes ekziston një praktikë e unifikuar që të pranohet kompensimi në shumë prej 5 euro, deri në 10 euro, për ditët e caktuara nga eksperti. Po ashtu edhe me nenin 27 të Rregullores për Përcaktimin e Kriereve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto

përgjegjësia përcaktohet se: "kohëzgjatja për ushqim të përforcuar për personin e lënduar e cakton mjeku censor. Ndërsa shpërblimi mujor për ushqimin e përforcuar pranohet deri në lartësinë prej 210 euro (7 euro në ditë)". Ndërsa lidhur me kërkesën në emër të rehabilitimit, I propozojmë gjykatës që ti refuzojë të njëjtat në mungesë të provave materiale, dhe për të njëjtat arsye edhe kërkesa për dëmtimet e veshmbathjeve nuk ka bazë për pranueshmëri. Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykatës I propozojmë që me rastin e vendosjes lidhur me njohjen ose jo të shpenzimeve të paditësve të marrë parasysh suksesin e paditësve në realizimin e kërkesëpadisë ashtu siç e parasheh neni 452.2 i Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore se: " Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë ti bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve."

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë leximin e ekspertizës së punuar nga ekspertët mjekësor Dr. Xh. S. ortoped – traumatolog dhe Dr. Sh. H., Psikiatër e dt.08.02.2021, raportin e aksidentit me nr. ER-3009-02/18 i dt.23.09.2018, aktgjykimin P.nr.867/18 i dt.16.10.2019 i përpiluar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, provat mjekësore të përshkruara në faqen 2(dy), faqen 3(tre) dhe faqen 4 (katër) të padisë (raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, me numër 14841 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me nr. të historisë 1131 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë reparti kirurgjisë, për G. M., si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin G. M., Raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, me numër 14844 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me numër të historisë 475 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë reparti ortopedisë, për F.M., si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin F.M., Raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, me numër 14842 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me numër të historisë 474 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë reparti ortopedisë, për F. M., si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin F. M., ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile me nr. serik E22800153 e lëshuar me dt.15.08.2018, për A. M., Raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, me numër 14846 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me numër të historisë 1132 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë reparti kirurgjisë, për A. M., si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin A. M., Raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, me numër 14849 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me numër të historisë 1133 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë reparti Kirurgjisë, për L. M., si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin L. M.), lexohen kuponët fiskal në origjinal të prezantuar nga pala paditëse dhe atë 121 kupa fiskal, lexohet fatura tatimore numër 0326001 e dt.26.03.2019 e lëshuar nga banja "Nëna Naile" në Kllokot, fatura tatimore 0326002 e dt.26.03.2019 e lëshuar nga banja "Nëna Naile" në Kllokot.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat penale konkretisht nga raporti i aksidentit me nr. ER-3009-02/18 i dt.23.09.2018 si dhe nga aktgjykimi P.nr.867/18 i dt.16.10.2019 i përpiluar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, u vërtetua fakti se aksidenti i ndodhur me dt. 23.09.2018, rreth orës 20:30/h, në aksin rrugor Prishtinë-Gjakovë, pikërisht në fshatin Cërmjan, Komuna e Gjakovës, është shkaktuar me fajin ekskluziv nga I. H., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, i cili duke e drejtuar automjetin e tij të markës “. . .” me tabela të regjistrimit . . ., ngjyrë e zezë metalike, rrezikon trafikun publik në përmasa të mëdha dhe vë në rrezik edhe jetën e njerëzve të tjerë si dhe pasurinë, nga pakujdesia nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit sipas kushteve dhe rrethanave të rrugës, i njëjti e lëshon shiritin e tij të rrugës të anës së djathtë të drejtimit të tij dhe kalon në shiritin e majtë në drejtim të kundërt, ku si pasojë e kësaj me pjesën ballore të anës së majtë e godet pjesën e përparmë të krahut të majtë automjetin e llojit “. . .”, me targa të regjistrimit . . ., me ngjyrë të bardhë të cilin e drejtonte G. M., duke shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe atë lëndime trupore dhe dëme materiale, i cili nga gjykata edhe është shpallur fajtor, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 e lidhur me par.1 të KPRK-së mirëpo e ka liruar nga dënimi për shkak të pasojave të veprës penale që e kanë goditur rëndë kryesin e veprës. Në këtë aksident këtu paditësit kanë pësua dëm jo material dhe material.

Baza e kërkesëpadisë së paditësve është vërtetuar nga aktgjykimi penal P.nr.867/18 i dt.16.10.2019 i përpiluar nga Gjykata Themelore në Gjakovë.

E paditura pjesërisht e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe nga lartësia, me pretendimin se këtu paditësit kanë kontribuar në shtimin e vëllimit të lëndimeve pasi që të njëjtit nuk a kanë pasur të vendosur rripin e sigurisë, e që kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e komunikacionit rrugor.

Për ta vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata ka nxjerr ekspertizat mjekësore të punuara nga Dr.Xh. S. ortoped traumatolog, i punësuar në SHSKUK-QKUK në Prishtinë, Klinika e Ortopedisë si dhe Dr. Sh. H. psikiatër, i punësuar në SHSKUK-QKUK, Instituti i psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësve e kanë dhënë mendimin profesional.

Për paditësin **G. M.**, sipas eksperteve bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe atë raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 14841 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me nr. të historisë 1131 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë reparti kirurgjisë, si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin G. M., RTG e kërkuar e bërë me dt.30.11.2020 si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë te paditësit me dt.27.11.2020, paditësi G. M. në aksident komunikacioni te dt.23.09.2018, ka pësuar këto lëndime trupore: Ndrydhje të anës së majtë të kraharorit, Plagë prerëse, dërmisheshe në kërcirin e majtë, Thyerje e brinjëve VIII dhe IX të anës së majtë, Therje e falangut të sipërm të gishtit të pestë të dorës së majtë. Këto lëndime trupore klasifikohen si **lëndime të rënda trupore**.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të të gjitha formave të dhimbjeve fizike trupore e aprovoi kërkesën në shumën prej 2.000,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda trupore ka pësuar: I. Dhembje fizike: a) Te intensitetit posaçërisht të lartë 30 min, (duke llogaritur momentin e aksidentit, e deri në dhënien e ndihmës mjekësore). b) Të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur 3 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, c) të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 30 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërliidhen me kohën e nevojshme për

konsolidimin primar kockor, ç) Të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin i njëjti ankohet për dhimbje të qafës dhe shpatullës së majtë si dhe dhimbjeve në kofshën dhe kërcirin e majtë të cilat janë të shprehura në sforcime fizike dhe ndryshime klimatike.

Në emër të frikës së pësuar, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1.500.00 euro dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësi ka përjetuar: Frikë primare e cila ka zgjatur 1-2 minuta. I njëjti e ka përjetuar dhe parë me sytë e vetë momentin e aksidentit, pasi që i njëjti ka qenë edhe vozitës i automjetit. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 7 ditë, deri në përfundim të trajtimit në repartin e kirurgjisë të spitalit Rajonal në Gjakovë, nga momenti kur është zgjuar dhe i ka vërejtur lëndimet ka filluar të ndiej dhimbje fizike, turbullirë në mendime, habi në të njëjtën kohë në mënyrë rapide, kanë filluar: ankth i gjeneralizuar, habia, frika deri në përfundim të trajtimit spitalor. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur rreth 3 muaj, herë pas here duke u përballur me pasojat shëndetësore të shkaktuar nga ky aksident, si frika, ankthi i gjeneralizuar, pagjumësi, rikujtimi i ngjarjes traumatike dhe shqetësime të ndryshme somatike për të cilat ankesa ka vizituar edhe psikiatrinë. Frika sekondare e intensitetit më të ulët ka zgjatur edhe për 2 muajt tjerë vijues, herë pas here sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion por edhe i rikujtohet momenti i aksidentit.

Në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5.95% gjykata e aprovoi kërkesën në shumën prej 1.500.00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit ortoped, paditësi ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor i cili është i shprehur në shkallë 5.95 %, për shkak të thyerjes së dy brinjëve, pika 5.1.1 A si dhe kufizimi i lëvizjes në nyjën metacarpus – phalangeale të gishtit të pestë të dorës së majtë pika 1.5.12 A të tabelës orientuese për përcaktimin e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të pësuar në aksidentin e komunikacionit të miratuar nga MSH.

Në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të shëmtimit gjykata e caktoi shpërblimin në shumën prej 750,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë ku sipas mendimit të ekspertit se te paditësi shëmtimi trupor është në shkallë të mesme për arsye të vrazdës me gjatësi 12.5x0.5 cm, në kërcirin e majtë.

Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 350.00 euro bazuar në mendimin e ekspertit nga e cila rezulton se ndihma dhe kujdesi i huaj ka pasur nevojë për 35 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare, veshja, zhveshja, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike si pasojë e lëndimit të marrë në këtë aksident.

Për ushqimin e përforcuar gjykata e ka caktuar shumën prej 350.00 euro, pasi që e ka vlerësuar si të drejtë ku sipas mendimit të ekspertit, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm me kohëzgjatje prej 50 dite, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se paditësi ka pasur nevojë për terapi fizikale dhe rehabilitim ku ka qenë i nevojshëm për 30 ditë, 2 here të ndara 20 dite në vitin e parë pas lëndimit dhe 10 dite në vitin e dytë pas aksidentit.

Nga faturat dhe kuponët fiskal, si dhe nga dëshmitë e siguruar-lëshuara nga institucionet shëndetësore shtetërore dhe private, gjykata i ka aprovuar shpenzimet e shërimit dhe mjekimit në shumën prej 700,00 euro, pasi që të njëjtat korrespondojnë respektivisht i përgjigjen trajtimit mjekësor të paditësit, e kjo bazuar në vlerësimin e ekspertëve mjekësor.

Për paditësin **F.M.**, sipas eksperteve bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe atë raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 14844 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me nr. të historisë 475 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë reparti ortopedisë, si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësin F.M., RTG e kërkuar e bërë me dt.30.11.2020 si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë te paditësit me dt.27.11.2020, paditësi F.M. në aksident komunikacioni te dt.23.09.2018, ka pësuar këto lëndime trupore: Thyerje të kualarshit të majtë me dislokim, Plagë prerëse në regjionin e kokës, ndrydhje të kraharorit, gërvishje në regjionin e kraharorit dhe të belit. Këto lëndime trupore klasifikohen si lëndime të rënda trupore.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të të gjitha formave të dhimbjeve fizike trupore e aprovoi kërkesën në shumën prej 1.800,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda trupore ka pësuar: I. Dhembje fizike: a) Te intensitetit posaçërisht të lartë 30 min, (duke llogaritur momentin e aksidentit, e deri në dhënien e ndihmës mjekësore). b) Të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur 24 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, c) të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 21 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërliken me kohën e nevojshme për konsolidimin primar kockor, ç) Të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin i njëjti ankohet për dhimbje të qafës dhe krahut të majtë të cilat janë të shprehura në sforcime fizike dhe ndryshime klimatike.

Në emër të frikës së pësuar, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1.300.00 euro dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësi frikë primare nuk ka përjetuar, pasi që i njëjti ka qenë i ulur prapa dhe nuk ka arritur ta shoh momentin e aksidentit. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 3 ditë deri në përfundim të trajtimit në repartin e ortopedisë të spitalit Rajonal në Gjakovë, nga momenti kur i ka vërejtur lëndimet ka filluar të ndiej dhimbje fizike dhe në të njëjtën kohë në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habia, frika deri në përfundim të trajtimit hospitalor. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur 2 muaj, nga vazhdimi i trajtimit shëndetësor nga shtëpia, kanë vazhduar peripeçitë si frika, ankthi i gjeneralizuar, pagjumësia, rikujtimi i ngjarjes traumatike dhe shqetësimet e ndryshme somatike për të cilat ankesa ka vizituar edhe psikiatrinë. Frika sekondare e intensitetit të ulët ka zgjatur edhe për 1 muaj vijues, janë prezantuar vështirësi për aktivitetet e përditshme të jetës e që ishte përcjell me shqetësime të karakterit ankioz dhe elementet të frikës, ankth. Ka ringjallje të shpeshta të simptomatologjisë së lartpërmendur si pasojë e traumës.

Në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5% gjykata e aprovoi kërkesën në shumën prej 1.000.00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit ortoped, paditësi ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësore i cili është i shprehur në shkallë 5 %, për shkak të ngjitjes së kualarshit të majtë me zhvendosje, pika 1.2.5 të tabelës orientuese për përcaktimin e zvogëlimit e aktivitetit jetësor të pësuar në aksidentin e komunikacionit të miratuar nga MSH.

Në emër të dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit gjykata e caktoi shpërblimin në shumën prej 500,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë ku sipas mendimit të ekspertit se të paditësi shëmtimi trupor është në atë në shkallë të lehtë për shkak të një vraje në kokë të mbuluar me flokë.

Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 300.00 euro bazuar në mendimin e ekspertit nga e cila rezulton se ndihma dhe kujdesi i huaj ka pasur nevojë për 28 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare, veshja, zhvesha, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, si pasojë e lëndimit të marr në këtë aksident.

Për ushqimin e përforcuar gjykata e ka caktuar shumën prej 300.00 euro, pasi që e ka vlerësuar si të drejtë ku sipas mendimit të ekspertit, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm me kohëzgjatje prej 40 dite, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se paditësi ka pasur nevojë për terapi fizikale dhe rehabilitim ku ka qenë i nevojshëm për 20 ditë, 2 here të ndara 10 dite në vitin e parë pas lëndimit dhe 10 dite në vitin e dytë pas aksidentit.

Nga faturat dhe kuponët fiskal, si dhe nga dëshmitë e siguruara-lëshuara nga institucionet shëndetësore shtetërore dhe private, gjykata i ka aprovuar shpenzimet e shërimit dhe mjekimit në shumën prej 700,00 euro, pasi që të njëjtat korrespondojnë respektivisht i përgjigjen trajtimit mjekësor të paditësit, e kjo bazuar në vlerësimin e ekspertëve mjekësor.

Për paditësen **F. M.**, sipas eksperteve bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe atë raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 14840 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me nr. të historisë 474 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë reparti ortopedisë, si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësen F. M., RTG e kërkuar e bërë me dt.30.11.2020 si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses me dt.27.11.2020, paditësja F. M. në aksident komunikacioni të dt.23.09.2018, ka pësuar këto lëndime trupore: Plagë prerëse në regjionin e kokëps, Ndrydhje të kraharorit, thyerje të kockave të rrezorit të të dy duarve. Këto lëndime trupore klasifikohen si lëndime të rënda trupore.

Në emër të të gjitha formave të dhimbjeve fizike trupore e aprovoi kërkesën në shumën prej 2.000,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësja, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda trupore ka pësuar: I. Dhembje fizike : a) Te intensitetit posaçërisht të lartë 30 min, (duke llogaritur momentin e aksidentit, e deri në dhënien e ndihmës mjekësore). b) Të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur 48 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e lartëcekura, c) të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 21 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërlihen me kohën e nevojshme për konsolidimin primar kockor, ç) Të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësen e njëjta ankohet për dhimbje të qafës, shpinë, krahun e djathtë si dhe në të dy bylyzyket e duarve, të cilat janë të shprehura në sforcime fizike dhe ndryshime klimatike.

Në emër të frikës së pësuar, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1.400.00 euro dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të

ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësja ka përjetuar, në kohëzgjatje prej 1-2 sekonda e cila nënkupton përjetimin dhe të pamurit me sy të vetë momentin e aksidentit pasi që e njajta ka qenë e ulur përpara në automjet dhe ka mundur ta shohë momentin e aksidentit. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 3 ditë deri në përfundim të trajtimit në repartin e ortopedisë të spitalit Rajonal në Gjakovë, nga momenti kur i ka vërejtur lëndimet ka filluar të ndiej dhimbje fizike, turbullirë në mendime, konfuzitet, habi në të njëjtën kohë në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habia, frika deri në përfundim të trajtimit hospitalor. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur 2 muaj, nga vazhdimi i trajtimit shëndetësor nga shtëpia, vijimi i vizitave kontrolluese specialistike, vështirësitë dhe peripetitë si frika, ankthi i gjeneralizuar, pagjumësia, rikujtimi i ngjarjes traumatike dhe shqetësimet e ndryshme somatike për të cilat ankesa ka vizituar edhe psikiatrinë. Frika sekondare e intensitetit të ulët ka zgjatur edhe për 2 muaj vijues, janë prezantuar vështirësi për aktivitetet e përditshme të jetës e që ishte përcjell me shqetësime të karakterit ankciroz dhe elementet të frikës, ankth. Ka ringjallje të shpeshta të simptomatologjisë së lartpërmendur si pasojë e traumës.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 9.76% gjykata e aprovoi kërkesën në shumën prej 2.000.00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim te drejte duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit ortoped, paditësja ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësore i cili është i shprehur në shkallë 9.76 %, për shkak të kufizimit të lehtë të bylyzkeve të të dy duarve, pika 1.4.2 të tabelës orientuese për përcaktimin e zvogëlimit e aktivitetit jetësor të pësuar në aksidentin e komunikacionit të miratuar nga MSH, e njësuar sipas formulës së baltazarit.

Në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të shëmtimit gjykata e caktoi shpërblimin në shumën prej 500,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim te drejte ku sipas mendimit të ekspertit se te paditësja shëmtimi trupor është në atë në shkallë të lehtë për shkak të një vraje në kokë të mbuluar me flokë.

Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 350.00 euro bazuar në mendimin e ekspertit nga e cila rezulton se ndihma dhe kujdesi i huaj ka pasur nevojë për 35 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundur plotësimin e nevojave elementare, veshja, zhveshje, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, si pasojë e lëndimit të marr në këtë aksident.

Për ushqimin e përforcuar gjykata e ka caktuar shumën prej 350.00 euro, pasi që e ka vlerësuar si te drejte ku sipas mendimit të ekspertit, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm me kohëzgjatje prej 50 dite, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se paditësja ka pasur nevojë për terapi fizikale dhe rehabilitim ku ka qenë i nevojshëm për 30 ditë, 2 here të ndara 20 dite në vitin e parë pas lëndimit dhe 10 dite në vitin e dytë pas aksidentit.

Nga faturat dhe kuponët fiskal, si dhe nga dëshmitë e siguruara-lëshuara nga institucionet shëndetësore shtetërore dhe private, gjykata i ka aprovuar shpenzimet e shërimit dhe mjekimit në shumën prej 700,00 euro, pasi që të njëjtat korrespondojnë respektivisht i përgjigjen trajtimit mjekësor të paditësit, e kjo bazuar në vlerësimin e ekspertëve mjekësor.

Për paditësen **A. M.**, sipas eksperteve bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe atë raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 14846 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me nr. të historisë 1132 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë reparti kirurgjisë, si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësen **A. M.**, si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit me dt.27.11.2020, paditësja **A. M.** në aksident komunikacioni të dt.23.09.2018, ka pësuar këto lëndime trupore: Ndrydhje të kokës e shoqëruar me gjakëmbledhje në regjionin ballor dhe përth dy orbitave, thyerje e dhëmbit 11 dhe të kurorave të dhëmbëve 12 dhe 21, plagë prerëse, dermishëse në buzën e poshtme të gojës. Këto lëndime trupore klasifikohen si lëndime të rënda trupore.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të të gjitha formave të dhimbjeve fizike trupore e aprovoi kërkesën në shumën prej 1.000,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësja, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda trupore ka pësuar: I. Dhembje fizike : a) Te intensitetit posaçërisht të lartë 30 min, (duke llogaritur momentin e aksidentit, e deri në dhënien e ndihmës mjekësore). b) Të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur 24 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e lartëcekura, c) të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 14 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërlidhen me kohën e nevojshme për rikuperimin e indeve të gojës, ç) Të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësen e njëjta ankohet për dhimbje të rralla në anën e djathtë të ballit, të cilat janë të shprehura në ndryshime klimatike.

Në emër të frikës së pësuar, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 700.00 euro dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësja nuk ka përjetuar frikë primare, pasi që e njëjta ka qenë e ulur mbrapa në automjet dhe nuk ka arritur ta shohë momentin e aksidentit. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 9 ditë deri në përfundim të trajtimit në repartin e kirurgjisë të spitalit Rajonal në Gjakovë, nga momenti kur i ka vërejtur lëndimet ka filluar të ndiej dhimbje fizike në kokë, qafë dhe gojë, në të njëjtën kohë në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habia, frika deri në përfundim të trajtimit hospitalor. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur 1 muaj, nga vazhdimi i trajtimit shëndetësor nga shtëpia, vijimi i vizitave kontrolluese specialistike, vështirësitë dhe peripetitë si frika, pagjumësia në formë të anktheve të natës, rikujtimi i ngjarjes traumatike për të cilat ankesa ka vizituar edhe psikiatrinë e fëmijëve. Frika sekondare e intensitetit të ulët ka zgjatur edhe për 1 muaj vijues, janë prezantuar vështirësi për aktivitetet e përditshme të jetës sic janë vijimi në shkollë, mbarvajtja në mësimet etj, e që janë përcjellë me ringjallje të shpeshta në formë të shqetësimeve dhe rikujtimeve.

Në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 3 % gjykata e aprovoi kërkesën në shumën prej 1.000.00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit ortoped, paditësja ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësore i cili është i shprehur në shkallë 3 %, për shkak të thyrjes së 3 dhëmbëve bazuar në pikën 1 të kreut të gjashtë të tabelës orientuese për përcaktimin e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të pësuar në aksidentin e komunikacionit të miratuar nga MSH.

Në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të shëmtimit gjykata e caktoi shpërblimin në shumën prej 500,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë ku sipas mendimit të ekspertit se te paditësja shëmtimi trupor është në atë në shkallë të lehtë për shkak të një vraje me gjatësi 0.5cm në anën e djathtë të ballit dhe vrazes tjetër me gjatësi 1cm në cepin e jashtëm të majtë të buzës së poshtme të gojës.

Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 250.00 euro bazuar në mendimin e ekspertit nga e cila rezulton se ndihma dhe kujdesi i huaj ka pasur nevojë për 14 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare, veshja, zhveshje, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, si pasojë e lëndimit të marr në këtë aksident.

Për ushqimin e përforcuar gjykata e ka caktuar shumën prej 250.00 euro, pasi që e ka vlerësuar si të drejte ku sipas mendimit të ekspertit, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm me kohëzgjatje prej 21 dite, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se paditësja ka pasur nevojë për terapi fizikale dhe rehabilitim ku ka qenë i nevojshëm për 7 ditë në raport me moshën.

Nga faturat dhe kuponët fiskal, si dhe nga dëshmitë e siguruarra-lëshuara nga institucionet shëndetësore shtetërore dhe private, gjykata i ka aprovuar shpenzimet e shërimit dhe mjekimit në shumën prej 250,00 euro, pasi që të njëjtat korrespondojnë respektivisht i përgjigjen trajtimit mjekësor të paditësit, e kjo bazuar në vlerësimin e ekspertëve mjekësor.

Për paditësen **L. M.**, sipas eksperteve bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe atë raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 14849 i dt.23.09.2018, fletë lëshimin me nr. të historisë 1133 nga SHSKUK Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë reparti kirurgjisë, si dhe dokumentacioni tjetër mjekësor për paditësen **L. M.**, si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit me dt.27.11.2020, paditësja **L. M.** në aksident komunikacioni të dt.23.09.2018, ka pësuar këto lëndime trupore: Ndrydhje të kokës dhe të kraharorit, gërvishtje të të dy gjunjëve. Këto lëndime trupore klasifikohen si lëndime të lehta trupore.

Në emër të të gjitha formave të dhimbjeve fizike trupore e aprovoi kërkesën në shumën prej 700,00 euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësja, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda trupore ka pësuar: I. Dhembje fizike : a) Te intensitetit posaçërisht të lartë 15 min, (duke llogaritur momentin e aksidentit, e deri në dhënien e ndihmës mjekësore). b) Të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur 24 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e lartëcekura, c) të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 10 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërlihen me kohën e nevojshme për rikuperimin e lëndimeve të lehta të kokës dhe trupit, ç) Të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësen e njëjta ankohet për dhimbje në anën e majtë të kraharorit, qafës në krah të djathtë dhe ekstremitetit të poshtëm të djathtë. Këto dhembje janë më të shprehura natën dhe në mesditë gjatë aktivitetit të punës të cilat shoqërohen me marramendje dhe lomë e shprehur me ndryshime klimatike.

Në emër të frikës së pësuar, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 500.00 euro dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësja ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej 1-2 sekonda. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 9 ditë deri në përfundim të trajtimit në repartin e kirurgjisë të spitalit Rajonal në Gjakovë, nga momenti kur i ka vërejtur lëndimet ka filluar të ndiej dhimbje fizike në kokë, qafë në të njëjtën kohë në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habia,

frika deri në përfundim të trajtimit hospitalor. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur 1 muaj, nga vazhdimi i trajtimit shëndetësor nga shtëpia, vijimi i vizitave kontrolluese specialistike, vështirësitë dhe peripetitë si frika, pagjumësia në formë të anktheve të natës, e njëjta ka fjetur me dritë të ndezur ka pasur rikujtimi të ngjarjes traumatike për të cilat ankesa ka vizituar edhe psikiatrinë. Frika sekondare e intensitetit të ulët ka zgjatur edhe për 2 javë të tjera vijuese, janë prezantuar vështirësi për aktivitetet e përditshme të jetës e që janë përcjellë me ringjallje të shpeshta në formë të shqetësimeve dhe rikujtimeve.

Për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 100.00 euro bazuar në mendimin e ekspertit nga e cila rezulton se ndihma dhe kujdesi i huaj ka pasur nevojë për 10 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare, veshja, zhveshje, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, si pasoj e lëndimit të marr në këtë aksident.

Për ushqimin e përforcuar gjykata e ka caktuar shumën prej 100.00 euro, pasi që e ka vlerësuar si të drejte ku sipas mendimit të ekspertit, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm me kohëzgjatje prej 20 dite, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se paditësja ka pasur nevojë për terapi fizikale dhe rehabilitim ku ka qenë i nevojshëm për 10 ditë në raport me moshën.

Nga faturat dhe kuponët fiskal, si dhe nga dëshmitë e siguruara-lëshuara nga institucionet shëndetësore shtetërore dhe private, gjykata i ka aprovuar shpenzimet e shërimit dhe mjekimit në shumën prej 250,00 euro, pasi që të njëjtat korrespondojnë respektivisht i përgjigjen trajtimit mjekësor të paditësit, e kjo bazuar në vlerësimin e ekspertëve mjekësor.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia fali besimin e plotë ekspertizës respektivisht mendimit profesional të ekspertëve mjekësor të lartpërmendur, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore si dhe ndaj të njëjtës ekspertize të autorizuarit e palëve ndërgjyqese nuk kanë pasur asnjë vërejtje dhe as ndonjë sqarim shtesë.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur për kompensimin e dëmit duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së lidhur me në nenin 136 të LMD-së i cili përcakton: *”Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, ndërsa me nenin 159 par.1 të po këtij ligji është paraparë se *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”*, ndërsa me par. 4 është paraparë *“Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht”*. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *“Në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1 i LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar etj.

Mbi bazën e kësaj gjendjeje faktike, gjykata vlerësoi se e paditura mban përgjegjësi primare në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësve me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësve t'ia kompensojë dëmin, meqë shkaktuesi i dëmit ka qenë i siguruar tek e paditura dhe për këtë arsye detyrimi për kompensim bie tek e paditura dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësive, konform nenit 18 të LSDA, lidhur me nenin 159 dhe 136 të LMD-së.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj këtu paditësve konform përgjegjësive në bazë të fajësive, të paraparë me dispozitat e nenit 18 të LSDA, lidhur me nenin 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësive së saj për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 173 al.2 të LMD-së, si dhe dëmit jo material konform nenit 183 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv I të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deritanishme të Gjykatave të Kosovës, e po ashtu duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarve – këtu paditësve, satisfaksion që ata të jenë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojë të mirat jomateriale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilat ata do ta kishin po qese të njëjtat nuk do t'i kishin humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkuara si në mendimin e ekspertëve Dr. Xh. S., ortoped-traumatolog, i punësuar në SHSKUK-QKUK Klinika e Ortopedisë në Prishtinë dhe ekspertit psikiatër Dr. Sh. H., i punësuar në SHSKUK-QKUK, Instituti i psikiatrisë Forenzike në Prishtinë. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirave dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin, të mos u shkojë për shtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi ngase konsideroi se shuma e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarve të silltet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësive deliktore civile të të paditurës. Sa i përket kërkesëpadisë për kompensimin e gjësendeve (veshmbathjeve), pala paditëse nuk i ka ofruar asnjë provë për këtë kërkesë, për vlerësimin e kërkesës.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës posaçërisht të institucionit shëndetësor publik dhe private, pjesë të shkresave të lëndës, por meqenëse të njëjtat janë shfrytëzuar nga ekspertet mjekësor për të dhënë ekspertizat mjekësore të cilave ekspertiza gjykata plotësisht i fali besimin, gjykata konsideroi se të njëjtat veç janë administruar dhe nuk ka nevojë që të administrohen veç e veç se edhe po të administroheshin veç e veç të njëjtat nuk do të ishin me ndikimin që në këtë çështje të vendosej ndryshe.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe deklarimin e palës së paditur se paditësit kanë kontribuar në shtimin e vëllimit të dëmit, mirëpo ka gjetur se një pretendim i tillë është i pa

bazuar dhe i pa mbështetur në prova. Paditësit 2, 3, 4 dhe 5 e kanë cilësinë e personit të tretë andaj edhe e kanë të drejtën të kërkojnë kompensimin nga cilido zotërues i automjetit, në rastin konkret e paditura është përgjegjëse pasi që përgjigjet për veprimet e të siguruarit të saj.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452 par.2 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.874/18, datë 16.09.2021

Gjyqtari
Malsor Kryeziu

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.